



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E DREJTËSISË  
QENDRA E PARANDALIMIT TË KRIMEVE TË TË MITURVE DHE TË RINJVE

Nr. 87 Prot.

Tiranë, më 09.02.2026

**URDHËR**

Nr. 12, datë 09.02.2026

**“PËR**

**MIRATIMIN E PLANIT TË INTEGRITETIT TË QENDRËS SË PARANDALIMIT  
TË KRIMEVE TË TË MITURVE DHE TË RINJVE 2025-2027”**

Në mbështetje të nenit 18, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, vendimit nr. 314, datë 15.05.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për organizimin, funksionimin, si dhe përcaktimin e rregullimeve specifike lidhur me strukturën dhe organikën e Qendrës së Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve”, të ndryshuar, si dhe vendimit nr. 859, datë 26.12.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2024-2030, planit të veprimit 2024-2026 në zbatim të saj dhe pasaportës së treguesve të performancës”,

**URDHËROJ:**

1. Miratimin e Planit të Integritetit të Qendrës së Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve 2025-2027, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
2. Ky urdhër publikohet për njohje në faqen zyrtare të Qendrës së Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**DREJTOR**

**KLAUDIA HASANILARI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E DREJTËSISË  
QENDRA E PARANDALIMIT TË KRIMEVE TË TË MITURVE DHE TË RINJVE

# PLAN INTEGRITETI

## 2025 - 2027

Miratuar me Urdhrin nr. 12, datë 09.02.2026, të Drejtorit të Qendrës së  
Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve

## **Grupi i Punës për hartimin e Planit të Integritetit në Qendrën e Parandalimit të Krimeve të Miturve dhe të Rinjve**

Denisa Veliu, Përgjegjës, Sektori i Hartimit të Planeve të Rehabilitimit dhe Zhvillimit të Programeve të Specializimit, **Kryetar**.

Erjola Salillari, Përgjegjës, Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, **Anëtar**.

Brezeida Manofi, Përgjegjës, Sektori i Mbikëqyrjes, Administrimit të Sistemit Elektronik dhe Statistikave, **Anëtar**.

Ira Muço, Specialist, Sektorin i Hartimit të Planeve të Rehabilitimit dhe Zhvillimit të Programeve të Specializimit, **Anëtar**.

Denisa Kamberi, Specialist, Sektori i Mbikëqyrjes, Administrimit të Sistemit Elektronik dhe Statistikave, **Anëtar**.

## TABELA E PËRMBAJTJES

<i>DEKLARATA E INTEGRITETIT INSTITUCIONAL</i> .....	4
<i>LISTA E SHKURTESAVE</i> .....	5
<i>1. HYRJE</i> .....	6
<i>2. PROCESI I HARTIMIT TË PLANIT TË INTEGRITETIT</i> .....	6
<i>2.1. Ngritja e grupit të punës për hartimin e Planit të Integritetit</i> .....	7
<i>2.2. Identifikimi dhe analiza e riskut</i> .....	7
<i>2.3. Vlerësimi i risqeve të integritetit</i> .....	11
<i>2.4. Plani i Veprimit për Menaxhimin e Riskut</i> .....	11
<i>3. QASJA METODOLOGJIKE</i> .....	11
<i>Përmbajtja e Planit të Integritetit</i> .....	12
<i>4. OBJEKTIVAT STRATEGJIKË, 2025-2027</i> .....	12
<i>5. RISQET DHE FAKTORËT E RISQEVE TË INTEGRITETIT</i> .....	13
<i>5.1. Mekanizmat e brendshëm rregullatorë dhe të kontrollit</i> .....	13
<i>5.2. Efektiviteti në menaxhimin e burimeve njerëzore</i> .....	15
<i>5.3. Transparenca me publikun</i> .....	17
<i>6. MONITORIMI I PLANIT TË INTEGRITETIT</i> .....	18
<i>7. PLANI I VEPRIMIT, 2025-2027</i> .....	19

## **DEKLARATA E INTEGRITETIT INSTITUCIONAL**

Përballja efektive me korrupsionin është thelbësore për Qendrën e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve, në funksion të forcimit të integritetit institucional, përmirësimit të mirëqeverisjes dhe ofrimit të shërbimeve cilësore për qytetarët e Republikës së Shqipërisë.

Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve ka përgjegjësi thelbësore në realizimin e veprimtarisë rehabilituese dhe riintegruese të të miturve dhe të rinjve, përmes mbikëqyrjes, mbështetjes dhe mbrojtjes së tyre pas përfundimit të masave apo dënimeve penale. Duke pasur një rol qendror në këtë proces, institucioni është i vetëdijshëm për nevojën që të shërbejë si shembull në respektimin e interesit publik, duke garantuar që çdo veprim të udhëhiqet nga standarde të larta integriteti, vlera etike dhe zbatim i plotë i ligjit.

Ky Plan Integriteti përfaqëson një shprehje konkrete të vullnetit dhe përkushtimit institucional për forcimin e integritetit, si dhe të një qëndrimi proaktiv në mbështetje të reformave dhe përpjekjeve kundër korrupsionit. Plani përfshin identifikimin e risqeve të integritetit sipas fushave funksionale të Qendrës së Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve, si dhe masat konkrete për parandalimin dhe adresimin e tyre.

Qëllimi kryesor i këtij Plani është përmirësimi i politikave, rregullave dhe praktikave në fushën e parandalimit të korrupsionit, si dhe forcimi i rezistencës institucionale ndaj shkeljeve të integritetit. Zbatimi efektiv i Planit të Integritetit pritet të ndikojë pozitivisht në rritjen e cilësisë së punës institucionale dhe në përmirësimin e shërbimeve të ofruara për qytetarët.

Institucioni është i ndërgjegjshëm se dhënia e shembullit personal dhe menaxhimi i integritetit duke filluar nga nivelet më të larta drejtuese, përmes respektimit të standardeve të larta profesionale dhe etikës në shërbimin publik, janë faktorë kyç për brendësimin dhe zbatimin efektiv të Planit nga të gjitha nivelet e institucionit. Në këtë mënyrë, synohet edhe rritja e besimit të publikut ndaj Qendrës së Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve.

## **LISTA E SHKURTESAVE**

**BNJ** - Burime Njerëzore

**MD** - Ministria e Drejtësisë

**MVRI** – Metodologjia e Vlerësimit të Riskut të Integritetit MVRI

**PI** – Plan Integriteti

**PT** - Programi i Transparencës

**QPKMR** – Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve

**AKPA** – Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive

**SHP** – Shërbimi i Provës

**ASHDMF** – Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës

**MA** – Ministria e Arsimit

## 1. HYRJE

Plani i Integritetit 2025–2027 i Qendrës së Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve (QPKMR) është hartuar në vijimësi të Planit të Integritetit 2022–2024, duke u mbështetur në analizën e rezultateve, sfidave dhe problematikave të evidentuara gjatë zbatimit të tij.

Qëllimi i Planit të Integritetit për Qendrën e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve është, së pari, vlerësimi i risqeve të integritetit që mund të komprometojnë aftësinë e QPKMR-së për të ushtruar funksionin e shërbimit publik në mënyrë të paanshme, transparente dhe të përgjegjshme, si dhe identifikimi i faktorëve që ndikojnë në shfaqjen ose rritjen e këtyre risqeve dhe, së dyti, formulimi i masave të përshtatshme dhe të zbatueshme për adresimin efektiv të tyre.

Vlerësimi i risqeve të integritetit dhe faktorëve përkatës është kryer për proceset e punës, të organizuara sipas fushave kryesore të veprimtarisë së institucionit. Këto fusha përfshijnë: menaxhimin financiar; menaxhimin e burimeve njerëzore; transparencën institucionale; arkivimin, ruajtjen dhe administrimin e dokumentacionit individual të të miturve, grumbullimin e të dhënave dhe përpunimin e statistikave të gjeneruara nga Sistemi i Integruar i të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur, përgatitjen e raporteve dhe analizave për përmirësimin e gjendjes dhe parandalimin e kriminalitetit për të miturit apo të rinjtë në konflikt me ligjin, si dhe me analizimin e të dhënave statistikore për të miturit e përfshirë në programet e rehabilitimit dhe parandalimit

## 2. PROCESI I HARTIMIT TË PLANIT TË INTEGRITETIT

Plani i Integritetit për Qendrën e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve është hartuar duke u mbështetur në dokumentin e Metodologjisë së Vlerësimit të Riskut të Integritetit (MVRI) për institucionet e qeverisjes qendrore. Qëllimi i Planit të Integritetit në këtë institucion është:

- i) vlerësimi i risqeve të integritetit, të cilat komprometojnë aftësinë e QPKMR për të kryer funksionin e shërbimit publik në mënyrë të paanshme dhe të përgjegjshme dhe i faktorëve që mund të mbështesin apo rrisin risqet e vlerësuara;
- ii) formulimi i masave të përshtatshme për adresimin e tyre.

Vlerësimi i risqeve të integritetit dhe faktorëve të tyre është kryer për proceset e punës sipas fushave të veprimtarisë së institucionit. Këto fusha përfshijnë:

- i) fusha e menaxhimit financiar;
- ii) fusha e menaxhimit të burimeve njerëzore;
- iii) fusha e transparencës;

- iv) fusha e prokurimeve publike;
- v) fusha e hartimit të planeve individuale të rishoqërimit dhe rehabilitimit të të miturve;
- vi) përpunimin e të dhënave statistikore të të miturve të përfshirë në programet e rehabilitimit dhe parandalimit.

### ***2.1. Ngritja e grupit të punës për hartimin e Planit të Integritetit***

Drejtuesi i Qendrës së Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve ngriti grupin e punës për vlerësimin e riskut të integritetit dhe përgatitjen e planit të integritetit të QPKMR-së. Në përbërje të grupit të punës janë punonjës të QPKMR-së të nivelit drejtues dhe ekzekutiv. Grupi i punës u kryesua nga një kryetar, i cili siguroi mbarëvajtjen e procesit dhe koordinimin e aktiviteteve në institucion.

Procesi i hartimit u zhvillua nëpërmjet një qasjeje të strukturuar dhe gjithëpërfshirëse, duke filluar fillimisht me realizimin e vlerësimit të riskut nga tre sektorët përkatës. U analizuan me kujdes burimet e mundshme të riskut dhe u përcaktuan masat parandaluese dhe korrigjuese për të garantuar një nivel të lartë integriteti në veprimtarinë institucionale gjatë viteve në vijim.

### ***2.2. Identifikimi dhe analiza e riskut***

Gjatë kësaj faze, grupi i punës i kushtoi vëmendje të veçantë analizës së kuadrit ligjor dhe atij të brendshëm rregullator për veprimtarinë e institucionit. Kjo fazë përfshiu edhe analizën e raporteve të ndryshme të QPKMR-së mbi veprimtarinë e saj, por dhe të jashtme mbi çështje që lidhen me fushat e veprimtarisë së institucionit. Grupi i Punës vijoi me identifikimin dhe analizimin e risqeve të integritetit dhe faktorëve të tyre, për proceset e punës në fushat funksionale të institucionit.

Në përputhje me raportimin paraardhës për periudhën Janar–Dhjetor 2024, janë analizuar objektivat dhe masat e zbatimit të planit të mëparshëm të integritetit, duke u fokusuar në efikasitetin e masave, përdorimin e burimeve dhe problematikat e evidentuara gjatë zbatimit. Më poshtë jepet pasqyrimi i detajuar mbi ecurinë e zbatimit të Planit të Integritetit 2022- 2024 sipas objektiveve.

#### ***Objektivi 1: Forcimi i mekanizmave të brendshëm rregullatorë dhe të kontrollit***

Përmes këtij objektivi synohej përmirësimi dhe forcimi i integritetit të Qendrës së Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve nëpërmjet miratimit dhe zbatimit të kuadrit të nevojshëm rregullator (rregulla dhe procedura) për çështje të veçanta të integritetit, si dhe gjithashtu të nxjerrjes dhe përmirësimit të kuadrit të brendshëm institucional në menaxhimin e integritetit

institucional.

Ky objektiv përmbante një numër prej **4 masash** specifike të planifikuara për t'u zbatuar nga njësitë e përfshira, të cilat i referohen kuadrit rregullator të brendshëm të integritetit si: përfshirja e aspekteve të veçanta të integritetit në Rregulloren e Brendshme, rregulla të veçanta për procesin e pranimit të dhuratave, si dhe miratimin e draftit final të rregullores së brendshme.

Gjatë periudhës raportuese **rezulton se 3 nga masat janë realizuar plotësisht**. Rregullorja e brendshme është dërguar pranë Ministrisë së Drejtësisë për miratim me shkresë nr.108 prot., datë 21.12.2021, dhe është miratuar nga Ministri i Drejtësisë me Urdhërin Nr.573, datë 02.10.2023 për *'Metodat e Brendshme të Punës dhe Sjelljen e Personelit të Qendrës së Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve'*.

Përsa i përket masës nr.4, 'Hartimi dhe Miratimi i Rregullores për Funkcionimin e Sistemit të Integruar të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur', QPKMR i ka përcjellë MD edhe nevojën për hartimin e Rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e Sistemit të Integruar të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur, në mbështetje të nenit 5 të ligjit nr. 10 325, datë 23.09.2010 "Për bazat e të dhënave shtetërore".

Në zbatim të Urdhrit nr. 623, datë 05.11.2021 të Ministrisë së Drejtësisë "Për ngritjen e Grupit të Punës mbi funksionimin e Sistemit të Integruar të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur", është ngritur Grupi i Punës për hartimin e Rregullores të funksionimit të Sistemit të Integruar të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur, në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë. Në draft rregullore janë përcaktuar rregullat dhe procedurat e përgjithshme për mirëfunksionimin e sistemit, rolet dhe përgjegjësitë e secilit institucion, të cilët kanë të drejtë të hedhin të dhënat në sistem, duke ju referuar edhe akteve ligjore në fuqi. Rregullorja nuk është miratuar ende nga ministri i Drejtësisë, si rezultat i ndryshimeve që do të bëheshin në aktet nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e funksionimit të Sistemit të Integruar, si dhe të QPKMR në tërësi, akte të cilat janë miratuar tashmë në muajin tetor 2022. Në vijim, gjatë vitit 2023 MD vlerësoi nevojën për përmirësimin e Sistemit të Integruar, ku me një urdhër të përbashkët ndërmjet AKSHI-t dhe MD është ngritur Grupi i Punës, i cili finalizoi dhe termat e referencës për përmirësimin e sistemit. Në përfundim, vijon që rregullorja të mos jetë miratuar ende nga Ministria e Drejtësisë dhe të mos jetë ndërmarrë ndonjë proces aktual për këtë në dijeninë tonë.

## *Objektivi 2: Rritja e efektivitetit në menaxhimin e burimeve njerëzore*

Përmes këtij objektivi synohej mirëfunksionimi i administratës së QPKMR nëpërmjet vendosjes së linjave të qarta hierarkike, sanksionimit të një procedure të qartë të të gjitha proceseve të punës në njësitë e institucionit, forcimit të kapaciteteve njerëzore e profesionale të fushës, por edhe

rekrutimin e stafit në mungesë në përputhje me strukturën dhe organikën në fuqi të ministrisë. QPKMR ka pasur në organikën e saj vende vakante në pozicionet e nivelit të mesëm drejtues, të ulët drejtues, të kategorisë ekzekutive, si dhe punonjës administrativë në njësitë përbërëse të saj. Këto vende vakante janë plotësuar dhe tani QPKMR ka një organikë të plotësuar.

Ky objektivi përmbante një numër prej **4 masash** specifike të planifikuara për t'u zbatuar nga njësitë e përfshira.

Gjatë periudhës raportuese janë realizuar masat dhe kryer aktivitetet, që rezultojnë nga monitorimi:

Për të siguruar një funksionim të mirë dhe për zhvillimin e Sistemit të Integruar të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur, QPKMR përgjatë periudhës Janar – Dhjetor 2024, ka organizuar disa takime dhe trajnime me mbikëqyrësit e sistemit, të mbajtura konkretisht në periudhën kohore nga muaji maj deri në muajin tetor 2024. Këto takime dhe trajnime përfshijnë të gjitha institucionet përdoruese të sistemit si Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë, Prokurorinë e Përgjithshme, Gjykatën, IEVP-në për të mitur, Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës, QPKMR-në, si dhe pjesëmarrës kanë qenë dhe ekspertët e kontraktuar nga UNICEF.

Në kuadër të forcimit të kapaciteteve për përdorimin e Sistemit të Integruar të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur, janë realizuar shtatë trajnime online gjithsej me fokus në rolin e përdoruesve të sistemit si hedhës të dhënash.

Është realizuar një trajnim specifik për stafin e QPKMR-së, me qëllim hedhjen e të dhënave në sistem dhe popullimin e tij me rastet e të miturve të ndjekur dhe trajtuar nga QPKMR.

Në bashkëpunim me ekspertët e kontraktuar nga UNICEF u realizua gjithashtu një trajnim me të gjithë mbikëqyrësit e institucioneve përgjegjëse për Sistemin e Integruar, me qëllim ngritjen e kapaciteteve të tyre për mbikëqyrjen e sistemit dhe nxjerrjen e raporteve të ndryshme sipas nevojave të institucioneve, si dhe aftësimin e tyre për trajnimet e përdoruesve të rinj për sistemin në vazhdimësi për institucionin e tyre.

Në lidhje me masën 3, në kushtet ku në organikën e QPKMR nuk është parashikuar pozicioni i punës në profil IT, mbetemi në proces komunikimi me Ministrinë e Drejtësisë dhe Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, për plotësimin e stafit me specialist IT.

Për sa më sipër, në kuadër të Programit Kombëtar të Praktikave të Punës, më datë 31.12.2024, stafi i QPKMR-së u plotësua me një specialist IT, me kontratë 1-vjeçare.

Gjithashtu, stafi i QPKMR, ka marrë pjesë në shumë sesione trajnimi, të certifikuara, mbi Drejtësinë Penale për të Mitur dhe tema të tjera që lidhen ngushtësisht me punën me të miturit në

konflikt me ligjin. Përsa i përket masës së katërt, koordinatori për të Drejtën e Informimit, për vitin 2024 ka marrë pjesë në një trajnim mbi legjislacionin e së drejtës për informim.

Kostoja e këtyre masave është administrative dhe nuk kanë të parashikuar kosto të brendshme financiare shtesë.

### *Objektivi 3: Sigurimi i nivelit më të lartë të transparencës me publikun*

Përmes këtij objekti synohet rritja dhe përmirësimi i transparencës dhe veprimtarisë së QPKMR, kundrejt grupeve të interesit dhe publikut nëpërmjet zbatimit dhe përdorimit të instrumenteve të së drejtës së informimit, konsultimit publik, të tjera forma të bashkëveprimit aktiv midis institucioneve të interesuara.

Ky objektivi përmbante **2 masa** specifike të planifikuara për t'u zbatuar nga njësitë e përfshira, të cilat i referohen specifikisht transparencës dhe informimit të publikut mbi aktivitetin dhe performancën e Qendrës së Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve për afatin kohor 2022-2024.

Për këtë periudhë monitorimi, pra për vitin 2024, objektivi 3 ka shënuar **arritje shumë të mira** në funksion të rritjes së transparencës dhe konsultimit publik.

Në kuadër të publikimeve dhe të vënies në dispozicion të publikut të gjerë të informacioneve dhe raporteve me natyrë financiare dhe natyrë informuese, QPKMR ka publikuar disa informacione mbi aktivitetet e organizuara, si dhe njoftime në faqen eeb të aksesueshme për të gjithë të interesuarit, përkatësisht njoftimi i fundit në linkun: <https://qpkmr.gov.al/programi-transparences/>.

Të gjitha këto informacione për publikun, publikohen dhe përditësohen në mënyrë periodike nga stafi i QPKMR. Kostoja e këtyre masave është administrative dhe pa kosto financiare të brendshme shtesë.

### *Objektivi 4: Efikasiteti në kryerjen e prokurimeve publike*

QPKMR ka publikuar regjistrin e prokurimeve në Programin e Transparencës. Për këtë objektivi është hartuar **vetëm 1 masë** për periudhën kohore 2022- 2024, e cila nuk është zbatuar, nuk është zhvilluar asnjë sesion trajnues për Komisionin e Prokurimit me Blerje të Vogël.

Në përfundim, duke pasur parasysh rëndësinë për integritetin, transparencën dhe parandalimin e konfliktit të interesit, masat e përealizuara për periudhën 2022-2024 do të parashikohen edhe në Planin e Ri të Integritetit 2025–2027.

### **2.3. Vlerësimi i risqeve të integritetit**

Gjatë kësaj faze, grupi i punës vlerësoi intensitetin e risqeve të analizuar në fazën e mësipërme. Grupi i punës identifikoi dhe analizoi faktorët e riskut që mund të pritet të mbështesin ose rrisin risqe të tilla. Gjatë kësaj faze të procesit u krye edhe një analizë për fushat e veprimtarisë që kërkonin vlerësim më të detajuar për shkak të ekspozimit të tyre më të madh ndaj risqeve të integritetit. Në vijim, risqet e vlerësuara dhe faktorët e tyre u renditën sipas përparësisë. Procesi vijoi me vlerësimin e efektivitetit të masave ekzistuese të kontrollit në institucion për risqet e vlerësuara dhe me propozimin e masave të reja për trajtimin e tyre.

### **2.4. Plani i Veprimit për Menaxhimin e Riskut**

Grupi i punës hartoi planin e veprimit për menaxhimin e risqeve të integritetit në institucion, i cili përfshiu masa të reja kontrolli apo përmirësimin e masave ekzistuese. Masat përshkruajnë aktivitetet që duhet të zbatohen për zvogëlimin apo eliminimin e risqeve të integritetit, afatet kohore dhe përgjegjësitë organizative për zbatimin e tyre.

Zbatimi i këtij Plani Integriteti është parashikuar për periudhën 2025-2027. Kostot financiare të këtij Plani do të mbulohen nga buxheti i Qendrës së Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve.

## **3. QASJA METODOLOGJIKE**

Për procesin e vlerësimit të riskut të integritetit në QPKMR, në përputhje me MVRI, u përdor metoda cilësore: përmes marrjes në konsideratë të informacioneve të dhëna në raportet e monitorimit 6-mujorë dhe vjetorë të Planit të Integritetit 2022-2024, si dhe raportet e auditit, etj.

Këto raporte shërbyen për të identifikuar ato masa dhe aktivitete të papërfunduara në kohë. Gjithashtu, procesi u shoqërua edhe me një analizë të kuadrit të brendshëm rregullator të QPKMR, i cili përfshin: urdhra, manuale, rregullore dhe akte të brendshme. Gjithashtu, u hulumtuan raporte të ndryshme mbi veprimtarinë e QPKMR si raportet e auditit.

## ***Përmbajtja e Planit të Integritetit***

Përmbajtja e Planit të Integritetit paraqitet si më poshtë:

- **Deklarata e Integritetit Institucional**, e cila pasqyron vullnetin dhe përkushtimin e titullarit të QPKMR-së për garantimin dhe promovimin e integritetit institucional;
- **Rëndësia e Planit të Integritetit për QPKMR-në**, ku theksohet se hartimi i këtij plani përbën një instrument kyç për forcimin e transparencës, rritjen e llogaridhënies dhe parandalimin e çdo forme të keqpërdorimit të funksioneve publike;
- **Prezantimi i përgjithshëm i procesit të hartimit të Planit të Integritetit të QPKMR-së**, i cili përfshin përshkrimin e fazave të procesit të planifikimit të integritetit, si dhe qasjen metodologjike të ndjekur gjatë hartimit;
- **Risqet e integritetit dhe faktorët shoqëruues**, që përfshijnë identifikimin dhe përshkrimin e risqeve të integritetit, si dhe faktorëve që i gjenerojnë ato, në fushat e përgjegjësisë së institucionit;
- **Plani i Veprimit**, i cili përmban masat e kontrollit dhe ndërhyrjet që duhet të ndërmerren për adresimin e risqeve të identifikuara dhe të vlerësuara, për periudhën 2025–2027.

Plani i Integritetit i është vënë në dispozicion të gjithë stafit të QPKMR-së, me qëllim që të shërbejë si një dokument dinamik dhe një instrument efektiv orientues për veprimtarinë e përditshme institucionale, duke garantuar veprim në përputhje me interesin publik, standardet e larta profesionale dhe një performancë të qëndrueshme institucionale.

## **4. OBJEKTIVAT STRATEGJIKË, 2025-2027**

Si rezultat i procesit të vlerësimit të riskut të integritetit, nëpërmjet këtij Plani Integriteti, Qendra e Parandalimit të Krimeve të Miturve dhe të Rinjve ka vendosur tre objektiva të realizueshëm brenda periudhës 2025-2027, nëpërmjet të cilave synohet që të minimizohen dhe adresohen risqet e konstatuara. Objektivi përfundimtar i këtij plani është ndërtimi i një sistemi të brendshëm efektiv dhe forcimi i kulturës së integritetit institucional.

Objektivat strategjikë 2025-2027 të Planit të Integritetit, janë:

1. Forcimi i kuadrit rregullator të integritetit dhe instrumenteve të luftës kundër korrupsionit;
2. Përmirësim i menaxhimit të burimeve njerëzore, kualifikim i shtuar dhe kapacitete të trajnuara;
3. Transparencë e shtuar dhe e plotë institucionale, partneritet me grupet e interesit dhe publikun e gjerë.

## 5. RISQET DHE FAKTORËT E RISQEVË TË INTEGRITETIT

Në këtë seksion paraqitet në mënyrë të përmbledhur analiza dhe rezultatet e procesit të vlerësimit të riskut të integritetit në QPKMR.

### 5.1. Mekanizmat e brendshëm rregullatorë dhe të kontrollit

Mjedisi i brendshëm rregullator përbën bazën mbi të cilën ndërtohet funksionimi institucional, ushtrimi i kompetencave ligjore dhe garantimi i integritetit në veprimtarinë e përditshme të Qendrës së Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve (QPKMR). Ky mjedis përfshin aktet e brendshme normative, procedurat e punës, strukturën organizative, si dhe ndarjen e qartë të përgjegjësi në përputhje me përshkrimet e punës.

Gjatë vitit 2024 është rishikuar dhe miratuar Rregullorja e Brendshme e Institucionit nga Ministria e Drejtësisë, me shkresë nr. 3837/2 prot., datë 04.09.2024. Ky proces ka kontribuar në përmirësimin e funksionimit administrativ dhe në qartësimin e roleve dhe përgjegjësi strukturore.

Spektori i Burimeve Njerëzore siguron informimin e punonjësve mbi aktet e brendshme rregullatore në momentin e emërimit në detyrë, si dhe në vijimësi, sipas nevojës. Gjithashtu, pranë këtij sektori, me urdhër të titullarit, është përcaktuar edhe Këshilltari i Etikës, i cili luan një rol të rëndësishëm në promovimin e standardeve etike dhe në parandalimin e shkeljeve të integritetit institucional. Gjithashtu, me urdhër të brendshëm, nr. 27, datë 26.03.2025, është krijuar njësi përgjegjëse për shqyrtimin e hetimit administrativ të sinjalizimit dhe shqyrtimin e kërkesës për mbrojtjen e sinjalizuesit, ndërsa me urdhër të brendshëm nr. 15, datë 14.02.2025, është miratuar rregullorja për hetimin administrative të kërkesës së sinjalizuesit për mbrojtjen nga hakmarrja në QPKMR.

Spektori i Mbikëqyrjes, Administrimit të Sistemit Elektronik dhe Statistikave ka një rol të rëndësishëm lidhur me mbikëqyrjen dhe funksionimin e Sistemit të Integruar të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur. Ky sistem përbën bazën kryesore për mbledhjen, përpunimin dhe analizimin e të dhënave statistikore mbi të miturit në konflikt me ligjin, të miturit viktime dhe të miturit dëshmitarë të veprave penale, duke ndikuar drejtpërdrejt në hartimin e politikave publike, monitorimin e fenomeneve kriminale dhe vlerësimin e efektivitetit të masave rehabilituese. Duke qenë se sistemi përdoret nga disa institucione të sistemit të drejtësisë, funksionimi korrekt i tij lidhet ngushtë me integritetin institucional, besueshmërinë e statistikave dhe transparencën e vendimmarrjes.

Një nga risqet kryesore të identifikuara lidhet me mosfunksionimin periodik të sistemit të integruar, për shkak të mungesës së një kontrate të rregullt për mirëmbajtje teknike dhe mbështetje profesionale. Ky risk shfaqet në forma të ndryshme, si ndërprerje të aksesit, fshirje të informacionit të hedhur nga institucionet përgjegjëse, probleme teknike të pazgjidhura në kohë etj.

Po ashtu, mungesa e një rregulloreje të miratuar dhe të detajuar për funksionimin e sistemit elektronik përbën një risk procedural dhe institucional. Në mungesë të një kuadri të qartë rregullator, përgjegjësitë e përdoruesve, procedurat e raportimit dhe mekanizmat e kontrollit mbeten të paformalizuara. Kjo situatë krijon hapësirë për interpretime subjektive, mungesë standardizimi dhe vështirësi në mbajtjen e përgjegjësisë individuale, duke rritur rrezikun e gabimeve ose neglizhencës dhe duke ndikuar negativisht në disiplinën institucionale.

Proceset e prokurimit publik përbëjnë një nga fushat me risk të shtuar për integritetin institucional, për shkak të përfshirjes së fondeve publike, kompleksitetit të procedurave dhe nevojës për respektimin rigoroz të parimeve të transparencës, konkurrencës dhe trajtimit të barabartë. Në këtë kuadër, në veprimtarinë e QPKMR-së identifikohen risqe që lidhen kryesisht me kufizimet në kapacitetet njerëzore dhe mungesën e trajnimeve të specializuara në fushën e prokurimeve publike. Këta faktorë mund të ndikojnë negativisht në cilësinë e dokumentacionit të prokurimit, në korrektësinë e vlerësimit të ofertave dhe në monitorimin e zbatimit të kontratave.

Bazuar në analizën e mjedisit të brendshëm rregullator dhe institucional, identifikohen këto sfida dhe risqe kryesore:

- Forcimi i mekanizmave të monitorimit dhe raportimit të risqeve të integritetit, përmes raportimeve periodike vjetore;
- Ndërgjegjësimi i vazhdueshëm i punonjësve mbi etikën profesionale, konfliktin e interesit dhe parimet e sjelljes etike në shërbimin publik;
- Trajnimi i specialistëve të përfshirë në proceset e prokurimit publik;
- Forcimi i mbikëqyrjes dhe garantimi i funksionimit efektiv të Sistemit të Integruar të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur;
- Realizimi i shërbimit të mirëmbajtjes për Sistemin e Integruar;
- Realizimi i përmirësimit të Sistemit të Integruar sipas nevojave të të gjitha institucioneve, përfshirë dhe QPKMR.
- Miratimi i një rregulloreje të Sistemit të Integruar të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur.

Masat e mësipërme të parashikuara për Sistemin e Integruar duhet të realizohen nga Ministria e Drejtësisë, si institucioni administrues i sistemit dhe QPKMR do të vijojë punën sipas udhëzimeve të MD.

Gjithashtu, duke sjellë në vëmendje se jemi në fazën e ngritjes së Institutit të Rehabilitimit të të Miturve, sfida të shumta do të hasen përsa i përket rishikimit të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, identifikimit të nevojës për miratimin e akteve të reja nënligjore që do të normojnë funksionimin e Institutit të Rehabilitimit të të Miturve, si dhe ndryshime në aktet ekzistuese, etj.

## **5.2. Efektiviteti në menaxhimin e burimeve njerëzore**

Në këtë pikë Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse ka një rol thelbësor në garantimin e funksionimit normal të institucionit, përmes administrimit të burimeve financiare, njerëzore dhe logjistike. Ky sektor ndikon drejtpërdrejt në eficiencën institucionale dhe në respektimin e parimeve të ligjshmërisë, transparencës dhe përdorimit racional të fondeve publike.

Një nga risqet kryesore të identifikuara lidhet me strukturën aktuale organizative, e cila nuk reflekton në mënyrë të plotë ngarkesën reale të punës dhe nevojat funksionale të institucionit. Kjo situatë manifestohet në mbingarkesë të disa sektorëve dhe në përdorim joefikas të burimeve njerëzore. Mbingarkesa e stafit rrit rrezikun e gabimeve procedurale, vonesave në përmbushjen e detyrimeve dhe uljes së cilësisë së shërbimeve. Në aspektin e integritetit, kjo situatë krijon kushte për shmangie nga procedurat standarde dhe rrit ekspozimin ndaj praktikave jo të qëndrueshme administrative.

Gjithashtu, mungesa e disa pozicioneve mbështetëse, si pozicioni i shoferit, apo ekspertit të IT përbën një risk organizativ dhe operacional. Aktualisht, këto nevoja mbulohen nga punonjës që kryejnë funksione të tjera, duke dalë jashtë përshkrimit të tyre të punës ose duke punësuar të rinj nga programi i praktikave të punës, me kontrata 1-vjeçare.

Kjo praktikë, edhe pse e diktuar nga nevoja, në planin afatgjatë mund të ndikojë negativisht në disiplinën administrative dhe në respektimin e standardeve të menaxhimit të burimeve njerëzore.

Përsa i përket Sektorit të Hartimit të Planeve të Rehabilitimit dhe Zhvillimit të Programeve të Specializimit, ky sektor ka një rol thelbësor në zbatimin e drejtësisë penale për të mitur, duke siguruar që masat penale dhe alternative të jenë të orientuara drejt rehabilitimit, riintegritimit social dhe parandalimit të recidivizmit. Sektori funksionon duke u mbështetur në dy shtylla kryesore:

- Rehabilitimi/Riintegrimi i të miturve/të rinjve pas kryerjes së dënimit

Ky proces konsiston në ndjekjen dhe mbikëqyrjen e rastit për të paktën 6 muaj pas lirimit, duke ofruar shërbime sipas kërkesave përkatëse të të miturve të liruar, ku mund të përfshihet punësimi, ndjekja e kurseve profesionale (certifikimi), vijimi i procesit mësimor në veçanti për të miturit

që nuk kanë mundur të mbyllin dot as arsimin e detyrueshëm 9-vjeçar, por jo vetëm, mbështetje në nisjen e start up-eve, etj.

Sfidat këtu kanë konsistuar në refuzimin e marrjes së shërbimit nga QPKMR nga ana e të miturve (kanë emigruar jashtë, kanë qenë në gjendje të mirë familjare social-ekonomike), por njëkohësisht problem madhor mbetet punësimi, pasi sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi, kriter punësimi është përfundimi i arsimit të mesëm të lartë, që në shumicën e rasteve cedon, dhe për këtë arsye QPKMR është detyruar të bashkëpunojë me OJF të cilat ofrojnë kurse falas, punësim, etj. Kjo mbetet një nga problematikat për t'u trajtuar me AKPA, ku të shihet mundësia e uljes së viteve të arsimit si kriter punësimi të paktën për këtë kategori individësh.

- Fushata sensibilizuese/informuese për nxënësit në shkolla

Ky proces konsiston në zhvillimin e sesioneve trajnuese në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme për nxënësit, me qëllim njohjen e konceptit të veprës penale, pasojat që ajo sjell, mënyrën sesi funksionon zinxhiri ndërinstytucional në këtë pikë, etj.

Duke qenë se QPKMR e shtrin veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e vendit dhe duke marrë parasysh numrin e madh të institucioneve arsimore në vend, bëhet shumë e vështirë që të realizohet 100% ky objektiv me një staf total prej 16 punonjësish që Qendra ka, përfshirë këtu edhe stafin mbështetës.

Pra, nevojitet rritja e numrit të punonjësve të kualifikuar në këtë fushë, bashkëpunim më i fortë me institucionet që kanë të njëjtën fushë përgjegjësie, në veçanti me institucionet arsimore, të cilat për fat të keq shpesh herë bëhen pikënisja e problematikave të kësaj natyre dhe duke mos pasur referim dhe informim në kohë reale, nuk mund të bëhet thujtë asgjë për të minimizuar risqet potenciale në të ardhmen.

Gjithashtu, mungesa e një manuali të formalizuar (sikurse parashikohet edhe në Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë për të Mitur) për të parashikuar në mënyrë eksplicite detyrat funksionale të secilit institucion në mënyrë të detajuar, do të minimizonte konfondimin e mbivendosjes së roleve/detyrave të secilit institucion të përfshirë dhe do të sillte maksimizimin e ofrimit të shërbimit të duhur për secilin rast. Mungesa e mekanizmave të formalizuar për koordinimin dhe monitorimin e këtij bashkëpunimi përbën një risk të rëndësishëm institucional.

Një koordinim i pamjaftueshëm ndërinstytucional mund të çojë në zbatim të pjesshëm ose joefektiv të planeve të rehabilitimit, duke ndikuar negativisht në përgjegjshmërinë institucionale dhe në efektivitetin e përgjithshëm të ndërhyrjeve rehabilituese.

Disa nga sfidat që identifikohen në institucion në çështjen e zhvillimit të burimeve njerëzore janë:

- Rishpërndarja e burimeve njerëzore në funksion të ngarkesës reale të punës, veçanërisht forcimi i Sektorit të Hartimit të Planeve të Rehabilitimit dhe Programeve të Specializimit, si sektori që ofron më shumë shërbime për të miturit e liruar, por jo vetëm.
- Rishikimi dhe miratimi i strukturës organizative, si prioritet kryesor për Sektorin e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse gjatë periudhës 2025–2027.
- Krijimi i pozicionit të shoferit në organikën e institucionit dhe specialistit IT për garantimin e funksionimit normal të shërbimeve logjistike.
- Koordinimi midis zinxhirit ndërinstytucional të implikuar në këtë fushë.

### **5.3. Transparenca me publikun**

Nga analiza përmbajtësore e faqes zyrtare të internetit të QPKMR-së rezulton se në të publikohen në mënyrë të rregullt të dhëna dhe informacione me karakter informues, njoftues dhe komunikues, të cilat lidhen me veprimtarinë e institucionit.

Koordinatori për të Drejtën e Informimit është caktuar me akt të titullarit dhe të dhënat përkatëse janë të publikuara në faqen zyrtare të institucionit, në përputhje me kërkesat ligjore.

Ndryshimet e fundit në legjislacionin për të drejtën e informimit kanë rritur nevojën për një vëmendje më të madhe në respektimin e afateve ligjore për kthimin e përgjigjeve ndaj kërkesave për informacion, nga ana e stafit teknik të ngarkuar me këtë përgjegjësi.

Programi i Transparencës (PT) përbën një instrument të rëndësishëm që kontribuon në rritjen e transparencës dhe përgjegjshmërisë institucionale, si një detyrim i parashikuar nga legjislacioni për mbrojtjen e së drejtës për informim. QPKMR e ka publikuar Programin e Transparencës në faqen e saj zyrtare, megjithatë informacioni i përfshirë në të rezulton të jetë pjesërisht i plotësuar.

Disa nga sfidat kryesore të identifikuar në institucion në lidhje me transparencën institucionale janë:

1. Nevoja për përditësim të rregullt dhe të plotë të informacionit publik në faqen zyrtare të internetit të QPKMR-së;
2. Rritja e kapaciteteve institucionale dhe profesionale të stafit përgjegjës për çështjet e transparencës dhe të drejtës për informim.

## **6. MONITORIMI I PLANIT TË INTEGRITETIT**

Objektivat strategjikë të këtij plani integriteti, do të implementohen nëpërmjet planit të veprimit, i cili parashikon afatet specifike, strukturat përgjegjëse dhe të dhëna të tjera për secilin aktivitet të parashikuar.

Implementimi i planit të integritetit do të monitorohet rregullisht çdo gjashtë muaj nga Koordinator i Integritetit në institucion. Koordinator është përgjegjës për monitorimin, analizën dhe vlerësimin e nivelit të implementimit të masave dhe aktiviteteve të parashikuara në planin e veprimit.

Rezultatet e monitorimit të planit të integritetit do të bëhen publike në kuadër të praktikës institucionale të transparencës.

## 7. PLANI I VEPRIMIT, 2025-2027

1. Kuadri i brendshëm rregullator							
1. Forcimi i kuadrit rregullator të integritetit dhe instrumenteve të luftës kundër korrupsionit							
Aktiviteti	Output-i	Afati	Struktura përgjegjëse	Prioriteti	Risku dhe faktorët e riskut	Masa për adresimin e riskut	Burimet
Rishikimi i Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, në kuadër të përfshirjes së dispozitave që lidhen me Institutin e Rehabilitimit të të Miturve	Ndryshimi i Kodit në funksion të parashikimit të rregullimit të funksionimit të Institutit	2027	MD MFE MA MB MSHMS QPKMR ASHDMF SHP	I Lartë	Dakordësimi mes grupit të punës mbi dispozitat konkrete që duhen ndryshuar dhe finalizimi i tyre	Përfshirja në grup e ekspertëve të fushës	Kosto administrative  Pa kosto financiare shtesë
Identifikimi i nevojës për miratimin e akteve të reja nënligjore që do të normojnë funksionimin e Institutit të Rehabilitimit të të Miturve, si dhe ndryshime në aktet ekzistuese	Miratimi/ndryshimi i akteve ligjore/nënligjore	2027	MD QPKMR Çdo institucion që ka si fushë përgjegjësie të miturit në konflikt me ligjin	I Lartë	Përputhshmëria me direktivat e BE  Harmonizimi i të gjithë akteve rregullatore, përfshirë strategji, plane veprimi, etj.	Përfshirja në grup e ekspertëve të fushës	Kosto administrative  Pa kosto financiare shtesë

Miratimi i Rregullores për metodat e brendshme të punës dhe sjelljes së personelit për Institutin	Rregullore për funksionimin e brendshëm të Institutit	2027	MD QPKMR MB	I Lartë	Ndarja e detyrave sipas sektorëve përkatës që do të ngrihen	Përfshirja në grup e ekspertëve të fushës	Kosto administrative  Pa kosto financiare shtesë
Trajnimi i specialistëve të përfshirë në proceset e prokurimit publik	Personel i trajnuar	2027	Njësia e Burimeve Njerëzore	I Lartë	Vështirësi në përdorimin e sistemit të APP (e-Prokurim) dhe zbatimin korrekt të procedurave përkatëse ligjore.	Trajnimi i personit përgjegjës për prokurimet, si dhe komisionit të prokurimit me blerje të vogël	APP ASPA  Burime të brendshme institucionale, pa kosto shtesë financiare.

## 2. Menaxhimi i burimeve njerëzore

**Objektivi: Përmirësim i menaxhimit të burimeve njerëzore, kualifikim i shtuar dhe kapacitete të trajnuara**

Aktiviteti	Output-i	Afati	Struktura përgjegjëse	Prioriteti	Risku dhe faktorët e riskut	Masa për adresimin e riskut	Burimet
------------	----------	-------	-----------------------	------------	-----------------------------	-----------------------------	---------

Rishpërndarja e burimeve njerëzore në funksion të ngarkesës reale të punës, veçanërisht forcimi i Sektorit të Hartimit të Planeve të Rehabilitimit dhe Programeve të Specializimit	Staf më i lartë në numër dhe më i kualifikuar për të mbuluar aktivitetet/sesionet informuese në të gjithë territorin e vendit	2027	Njësia e burimeve njerëzore.	I lartë	Vonesë në miratimin e strukturës së re	Vendosja e afateve për grupin e punës që do jetë pjesë e kësaj iniciative	Burimet njerëzore të institucionit.  Kosto administrative  Pa kosto financiare
Rishikimi dhe miratimi i strukturës organizative, si prioritet kryesor për Sektorin e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse gjatë periudhës 2025–2027	Staf më i lartë në numër dhe më i kualifikuar	2027	Njësia e burimeve njerëzore	I lartë	Vonesë në kryerjen e detyrave të natyrës financiare	Shpallja e vendeve vakante	Kosto administrative  Pa kosto financiare
Krijimi i pozicionit të shoferit në organikën e institucionit dhe specialistit IT për garantimin e funksionimit normal të shërbimeve logjistike	Plotësimi i stafit me punonjës.	2027	Njësia e burimeve njerëzore	I lartë	Vështirësi në kryerjen e aktiviteteve jashtë kryeqytetit, si dhe në detyrat që kërkojnë formim IT	Plotësimi me staf të specializuar	Kosto administrative  Ka kosto financiare nëse do të plotësohen këto dy pozicione për efekt page
Koordinimi midis institucioneve, në veçanti me MA	Rikthimi në shkollë i të miturve që e kanë ndërprere procesin mësimor	2027	MD QPKMR MA	I lartë	Rikthimi i të miturve në rrugë nëse nuk pranohet të rikthehen në institucionet arsimore	Bashkëpunim më efikas me institucionet arsimore	Kosto administrative  Pa kosto financiare

### 3. Transparenca me publikun

**Objektivi: Transparençë e shtuar dhe e plotë institucionale, partneritet me grupet e interesit dhe publikun e gjerë**

<b>Aktiviteti</b>	<b>Output-i</b>	<b>Afati</b>	<b>Struktura përgjegjëse</b>	<b>Prioritet i</b>	<b>Risku dhe faktorët e riskut</b>	<b>Masa për adresimin e riskut</b>	<b>Burimet</b>
Përditësim të rregullt dhe të plotë të informacionit publik në faqen zyrtare të internetit të QPKMR-së	Raport periodik i publikuar në faqen zyrtare	2027	Struktura përgjegjëse për transparencën	I lartë	Publik i painformuar mbi veprimtarinë e institucionit, si rezultat i mospublikimit të aktiviteteve të institucionit në faqen zyrtare.	Informimi periodik i publikut mbi të gjitha aktivitetet e institucionit.	Burime të brendshme institucionale, pa kosto shtesë financiare.
Rritja e kapaciteteve institucionale dhe profesionale të stafit përgjegjës për çështjet e transparencës dhe të drejtës për informim	Personel i trajnuar	2027	Njësia e burimeve njerëzore	I lartë	Mundësi për mos-ofrim të informacionit të rregullt nga ana e institucionit për publikun për arsye të mungesës së informacionit mbi legjislacionin e së drejtës për informim.	Pjesëmarrja në trajnime të detyruara të Koordinatorit për të Drejtën për Informim.	Burimet njerëzore.  ASPA  Pa kosto financiare shtesë.